

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN VOSKOPOJË KORÇË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Voskopojë Korçë**, me objekt: “*Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, aktivitetin ekonomik e financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve të qëndrueshme, dhënien me qira të objekteve, funksionimi i policisë komunës, prokurimet me fonde publike, taksat dhe tarifët vendore, etj.*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 30.06.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 145, datë 08.10.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 451/7, datë 08.10.2014, i ka rekomanduar z. Nexhip Bacelli, Kryetar i Komunës Voskopojë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1.1 Gjetja nga auditimi: Për periudhën e audituar 2011-30.06.2014, nuk janë regjistruar në kontabilitet dhe nuk ishin vjelë taksat vendore për vlerën **839,553 lekë**, e cila përbën mungesë të ardhurash të munguara në buxhetin e Komunës Voskopojë, (kryesisht të fshatit Voskopojë), respektivisht: Taksë Toke në vlerën 435,114 lekë, Taksë Ndërtese në vlerën 168,059 lekë, Tarifë Pastrimi në vlerën 177,100 lekë, Tarifë ndriçimi në vlerën 78,600 lekë. Në kundërshtim me nenet 11 dhe 14 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për Sistemimin e Taksave Vendore*” dhe neneve 68, 69, 70, 74, 76 dhe 111, të ligjit 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*”. i ndryshuar.

1.2 Niveli i prioritetit: Vlera e mësipërme në shumën 839,553 lekë ka nivel të lartë prioriteti dhe është me ndikim të lartë në pasqyrat financiare të subjektit auditues.

1.3 Rekomandimi: Zyra e taksave të Komunës Voskopojë, të nxjerrë njoftim vlerësimet dhe të regjistrohen në kontabilitet taksat vendore për popullatën në vlerën 839,553 lekë, (Aneksi nr. 1, bashkëlidhur), të ndara si më poshtë:

- Taksë toke në vlerën .435,114 lekë
- Taksë ndërtese në vlerën 168,059 lekë
- Tarifë pastrimi në vlerën 177,100 lekë
- Tarifë ndriçimi në vlerën 78,600 lekë

Menjëherë

2.1 Gjetja nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura rezulton se për vitin 2014 është planifikuar të merren nga 13 subjekte Biznesi i Vogël, të ardhura nga taksat në vlerën 139,000 lekë, ndërkohë deri më datën 30.07.2014 vetëm nga 3 subjekte ishin paguar detyrimet prej 32,060 lekë, duke mbetur pa u paguar edhe vlera prej **106,900 lekë**.

Edhe pse ish-Kampi i pionierëve, Voskopojë sot hotel “Akademia” në pronësi të B.S.SH.P, sipas kontratës nr. 61, datë 09.01.2008 është dhënë me qera për një afat prej 20 vjetësh. Ndërkohë nga Komuna Voskopojë nuk ishte marrë asnjë lloj takse apo tarifë, me

pretendimin se ky objekt është në pronësi të sindikatave dhe se ky subjekt i paguan detyrimet tatimore në Drejtorinë Rajonale Tatimore Korçë.

2.2 Niveli i prioritetit: Vlera e mësipërme në shumën 106,900 lekë ka nivel të mesëm prioriteti dhe është me ndikim të mesëm në pasqyrat financiare të subjektit auditues.

2.3 Rekomandimi: Zyra e taksave të Komunës Voskopojë të marrë masa dhe të përcaktojë afatet e pagimit të taksave duke njoftohen të 13 subjektet për pagimin e taksave vendore për vitin 2014 edhe për vlerën prej **106,900 lekë**.

-Të nxirret njoftim vlerësimi tatimor në zbatim të pikës 3, nenit 70, “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “ *Për Procedurat Tatimore*” dhe t’i dërgohet me shkresë zyrtare ish-kampit të pionierëve, sot, Hotel “Akademia” me qëllim pagesën e taksave dhe tarifave vendore, si gjithë subjektet e tjera që zhvillojnë aktivitetin në territorin e Komunës Voskopojë.

Menjëherë

3.1 Gjetja nga auditimi: Nga Komuna, në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk janë hartuar politikat, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësisë publike që ai drejton, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave.

3.2.Rekomandimi: Komuna Voskopojë, në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të hartojë politikat, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësisë publike, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave.

Menjëherë

4.1 Gjetja nga auditimi: Nuk është miratuar një sistem i rregullave specifike e të procedurave për administrimin ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, Kap. III.

4.2 Rekomandimi: Komuna Voskopojë të miratojë një sistem të rregullave specifike e të procedurave për administrimin ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike.

Menjëherë

5.1 Gjetja nga auditimi: Nga punonjësit e financës nuk është bërë përcaktimi i gjendjes së vlerave monetare në arkë me anë të inventarizimit fizik minimalisht një herë në muaj sipas kërkesave të UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “*Menaxhimi i aktiveve në sektorin publik*” pika 80, “*Përcaktimi i gjendjes së vlerave monetare në arkë dhe letrave me vlere bëhet nga nëpunësi zbatues me anë të inventarizimit fizik minimalisht një herë në muaj*”.

5.2 Rekomandimi: Përgjegjësja e zyrës së financës së komunës të bëjë përcaktimin e gjendjes së vlerave monetare në arkë me anë të inventarizimit fizik minimalisht një herë në muaj sipas kërkesave të urdhrin të Ministrit Financave të cituar më sipër.

6.1 Gjetjet nga auditimi: Nga auditimi rezulton se për objektin “*Ndërtimi i rrugës me kalldrëm*” është zhvilluar tender i hapur më datën 28.08.2012 dhe fitues është shpallur Operatori “B..D & H...C” sh.p.k me NUIS K21413002P Rrethi: Tiranë, me të cilin është lidhur kontrata pa numër protokolli, datë 13.09.2012 me vlerë 28,573,998 lekë, me tvsh. ndërmjet Komunës Voskopojë Korçë ,përfaqësuar nga kryetari i Komunës Nexhip Bacelli, dhe operatorit ekonomik “B..D & H...I”.

Për periudhën nga lidhja e kontratës datë 13.09.2012 deri më datën 24.07.2014 kur kanë kaluar mbi 24 muaj ose 2 vjet, nga vlera e kontratës prej 28,573,998 lekë i janë likuiduar

Operatori Fitues “B..D& H..I” sh.p.k vlera prej 18,372,282 lekë, duke mbetur pa u likuiduar edhe vlera e punimeve prej 10,201,716 lekë ose në masën 35 %.

Nga verifikim rezulton se punimet në këtë objekt sipas kontratës duhet të përfundonin për një afat prej 3 muaj, duke filluar më datën 13.09.2012 deri 13.12.2012. Punimet në këtë objekt janë shtyrë 2 herë për arsye të ndryshme dhe kanë përfunduar më datën 11.10.2013, ose 11 muajsh tej afatit të parashikuar në kontratë.

Edhe pse kishin kaluar 9.5 muaj nga njoftimi i përfundimit të punimeve datë 11.10.2013 deri më datën 30.07.2014 objekti nuk kishte përfunduar dhe marrë në dorëzim. Për këtë arsye ndërmjet firmës zbatuese, mbikëqyrësit të punimeve dhe kryetarit të Komunës Voskopojë është hartuar Akt-Marrëveshja nr.284, datë 25.07.2014, **duke rikërkuar përsëritjen e punimeve në të dy segmentet e rrugës.**

6.2 Rekomandimi: Komuna Voskopojë për përfundimin e ndërtimit të objektit “Ndërtimi i rrugës me kalldrëm”, të ndjekë zbatimin e akt marrëveshjes nr. 284, datë 25.07.2014 ndërmjet firmës zbatuese, “B..D” sh.p.k dhe “H..I” mbikëqyrësit të punimeve A.T. dhe kryetarit të Komunës Voskopojë, **duke përsëritur punimet në masën 100%, në të 2 segmentet e rrugës dhe konkretisht:**

a. Rruga “Rilindja Voskopojare” me gjatësi rreth 230 ml dhe gjerësi rreth 6 ml në pjesën e shtratit të rrugës dhe trotuaret duhet të riparohet nga dëmtimet e vërejtura në masën 100% të gjatësisë dhe gjerësisë së saj, duke përfshirë edhe trotuaret e rrugës.

b. Rruga “Gjergj Simon Sina” me gjatësi rreth 190 ml dhe gjerësi rreth 6 ml në pjesën e shtratit të rrugës dhe trotuaret duhet të riparohet nga dëmtimet e vërejtura në masën 100 % të gjatësisë dhe gjerësisë së saj, duke përfshirë edhe trotuaret e rrugës.

Në se deri më datën 30.11.2014, nuk përfundojnë punimet dhe nuk meret në dorëzim objekti “Ndërtimi i rrugës me kalldrëm”, sipas preventivit, projektit të fituar në tender dhe kontratës datë 13.09.2012 me vlerë 28,573,998 lekë, me t.vsh, të lidhur ndërmjet Komunës Voskopojë Korçë, përfaqësuar nga kryetari i Komunës dhe operatorit ekonomik “B..D & H..I”. Përveç se nuk do i likuidohet diferenca e situacionit prej 10,201,716 lekë, (ose 35% e vlerës mbetur), vlera e likuiduar deri më datën 30.07.2014 prej **18,372,282 lekë do të konsiderohet dëm ekonomik** dhe Komuna, të kërkojë në rrugë ligjore kthimin e saj.

Deri më datën 30.11.2014

7.1 Gjetja nga auditimi: Komuna nuk ka marrë me proces verbal sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullosor i (transferuar) Komunës Voskopojë, mbi bazën e VKM nr. 782, datë 04.06.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njërive të qeverisjes vendore, komuna Voskopojë, të Qarkut të Korçës”, nuk janë përcaktuar kategoritë dhe mungojnë hartat përkatëse, ku të përcaktohen kufijtë dhe planvendosjet e tyre.

7.2 Rekomandimi: Nga Komuna Voskopojë të bashkëpunohet me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor dhe Ministrinë e Mjedisit që për pronat fond pyjor dhe kullosor që i janë transferuar Komunës me VKM, të merren hartat përkatëse të përcaktohen kategoritë, kufijtë duke u shoqëruar me planvendosjet e tyre dhe duke i dokumentuar këto me proces verbal.

Deri më datën 30.03.2015

8.1 Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave me shkresën nr. 145, dt. 8.4.2014 të paraqitura nga vetë Komuna Voskopojë, rezulton se në territorin e kësaj Komune, janë kryer shumë ndërtime, nga të cilat disa janë pa lejë ndërtimi dhe disa të tjera në proces legalizimi. Në kushtet kur Komuna Voskopojë nuk ka krijuar strukturën e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik, për kontrollin e territorit nuk ka lidhur kontratë me Inspektoratin Ndërtimor

Urbanistik të Qarkut Korçë, në kundërshtim me nenin 18 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”.

8.2 Rekomandimi: Komuna Voskopojë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për identifikimin dhe inventarizimin sipas fshatrave të ndërtimeve pa lejë, duke informuar Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik të Qarkut Korçë dhe Inspektoratin Urbanistik Kombëtar.

Deri më datën 31.10.2014

B.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV,-Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, **nga ana e titullarit të njësisë publike** (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative dhe (Nëpunësi zbatues), të kryejë kontabilizimet dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe përmbartimore me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, **në vlerën 21,386,584 lekë, si më poshtë:**

1.1 Gjetja nga auditimi: Zyra e urbanistikës, së Komunës Voskopojë, nuk kishte kryer llogaritjet të sakta të taksës së ndikimit në infrastrukturë mbi preventivin e llogaritur me çmimin e Entit Kombëtar të Banesave, pasi 27 qytetarëve u ishte llogaritur si taksë e ndikimit në infrastrukturë, vetëm taksa në masën 2 % të caktuar nga Këshilli i Komunës, pa u llogaritur dhe kërkuar pagimi i taksës në masën 1% mbi vlerën e preventivit sipas nenit 51 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar. Për pasojë për periudhën e viteve 2010 deri 16.07.2011 rezultoi se nga mos pagesa e kësaj takse është krijuar një e ardhur e munguar në buxhetin e Komunës Voskopojë nga 27 qytetarë në vlerën prej 5,293,614 lekë, nga e cila vlera prej 2,457,865 lekë, sa llogaritur më pak, në kundërshtim me VKM nr. 173, datë 29.03.2006 “Për miratimin e kostos minimale fiskale në ndërtim dhe për mënyrën e përcaktimit të çmimit të shitjes banesave”, ndërsa vlera prej 2,729,689 lekë mos pagesë taksë ndikimi në infrastrukturë.

1.2 Niveli i prioritetit: Vlera e mësipërme në shumën 5,293,614 lekë ka nivel të lartë prioriteti dhe është me ndikim të lartë në pasqyrat financiare të subjektit auditues.

1.3 Rekomandimi: Zyra e Taksave në bashkëpunim me Zyrën e Urbanistikës dhe Financës të Komunës Voskopojë të nxjerrë njoftim vlerësimet për 27 personat në vlerën prej **5,293,614** lekë, të cilët nuk kanë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë mbi preventivin e llogaritur me çmimin e Entit Kombëtar të Banesave dhe taksën në masën 1% mbi vlerën e preventivit.

Deri më datën 30.03.2015

2.1 Gjetja nga auditimi: Për periudhën e audituar 2011-30.06.2014, nuk janë regjistruar në kontabilitet dhe nuk ishin vjelë taksat vendore për vlerën 437,970 lekë, e cila përbën mungesë të ardhurash të munguara në buxhetin e Komunës Voskopojë, në kundërshtim me nenet 11 dhe 14 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemimin e Taksave Vendore” dhe neneve 68,69,70,74,76 dhe 111, të ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”.

2.2 Niveli i prioritetit: Vlera e mësipërme në shumën 437,970 lekë ka nivel të lartë prioriteti dhe është me ndikim të lartë në pasqyrat financiare të subjektit auditues.

2.3 Rekomandimi: Zyra e taksave të Komunës Voskopojë, të nxjerrë njoftim vlerësimet dhe të regjistruhen në kontabilitet taksat vendore për vlerën **437,970** lekë respektivisht:

-Taksë nga 7, bizneset në vlerën 161,750 lekë

-Tarifë për ujin e pijshëm në vlerën 276,220 lekë

Deri më datën 31.12.2014

3.1 Gjetja nga auditimi: Në 3 raste i është likuiduar tepër vlera prej **124,614** lekë subjektit “**M..I**” shpk, duke mos i shoqëruar me raportet e analizave nga Inspektorati Qendror Teknik për sasinë e produktit dhe pa procesverbal për marrjen në dorëzim të mallit sipas kushteve të kontratës. Përllogaritja e çmimit nuk është bazuar në buletinin e APP për çmimet referuar bursës REUTERS për “*gazoil 0.1%*” dhe kursit zyrtar të këmbimit i dollarit amerikan USD, nga Banka e Shqipërisë. Këto pagesa janë bërë në kundërshtim, me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “*Për rregullat e prokurimit publik*” Kreu VIII, pika 2/c “*Nëse çmimi, gjatë kohës së zbatimit të kontratës.....ndryshon dukshëm, me kërkesë me shkrim të palëve, pasqyron, në faturat periodike të shitjes, çmimin e mallit, mbështetur në deklaratën doganore SAD.*”

3.2 Niveli i prioritetit: Vlera e mësipërme në shumën 124,614 lekë ka nivel të ultë prioriteti dhe është me ndikim të paktë në pasqyrat financiare të subjektit auditues.

3.3 Rekomandimi: Komuna Voskopojë të kërkojë në rrugë ligjore subjektit “**M..I**” shpk vlerën **124,614** lekë e cila përfaqëson mos llogaritjen e furnizimit sipas kontratës, të likuiduar, si rezultat i mos respektimit të çmimit miratuar për furniturën bazuar në buletinin e APP, deklaratën SAD, **respektivisht:** vlerën 98,316 lekë sipas kontratës shtesë “*Blerje karburant për vitin 2012*”, vlerën 15,922 lekë sipas kontratës shtesë “*Blerje karburant vitin 2013*” dhe vlerën 10,376 lekë sipas kontratës shtesë “*Blerje karburant për vitin 2014*”

Deri më datën 30.11.2014

4.1 Gjetja nga auditimi: Pa lidhur kontratë kryetari i Komunës Voskopojë me vendimin nr. 05, datë 01.09.2010, ka emëruar znj. **N.T.** me detyrë përgjegjëse e zyrës të Komunës Voskopojë, për periudhën 01.09.2010-31.12.2012 duke u paguar nga fondet e Komunës Voskopojë për 10 muaj x 30,495 lekë/muaj = 304,959 lekë. Krahas marjes së pagës në Komunë, ka përfituar edhe pensionin e pleqërisë për 10 muaj x 25,055 lekë/muaj ose **250,556** lekë, **dëm ekonomik** për buxhetin e shtetit të Sigurimeve Shoqërore.

-Po me vendimin nr. 01, datë 02.02.2014 të kryetarit të Komunës, pa u lidhur kontratë ka emëruar në detyrën e Inspektorit të Bujqësisë dhe Menaxhimit të Tokave, **z. H.P.** me pagë mujore bruto prej 45,750 lekë, ku përveç pagës në Komunë, për periudhën 02.02.2014 deri 28.02.2014 ka përfituar edhe vlerën e pensionit të pleqërisë për shumën **20,842** lekë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore.

4.2 Niveli i prioritetit: Vlera e mësipërme në shumën 271,398 lekë ka nivel të ultë prioriteti dhe është me ndikim të paktë në pasqyrat financiare të subjektit auditues.

4.3.Rekomandimi:Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000“*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “*Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë*”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, Komuna Voskopojë **të veprojë si më poshtë:**

a. T’i dërgohet shkresë Drejtorisë së Përgjithshme të Sigurimeve Shoqërore, për kryerjen e ndalesës për vlerën **prej 250,556** lekë, ndaj znj. **N.Th.** ish-Përgjegjëse e zyrës së Urbanistikës në Komunën Voskopojë, pasi për periudhën 10 mujore me ndërprerje nga data 01.09.2010 deri 31.12.2012, përveç pagës në Komunë, ka përfituar padrejtësisht edhe pension pleqërie në vlerën 250,556 lekë.

b. Ti xhirohet Drejtorisë së Përgjithshme të Sigurimeve Shoqërore, ndalesën e pensionit pleqërisë prej **20,842** lekë, e cila është arkëtuar në Komunë, ndaj z. **H.P.** me detyrë inspektor i tokave në Komunë, pasi për periudhën 1 mujore nga data 01.02.2014 deri 28.02.2014, përveç pagës në Komunë ka përfituar padrejtësisht edhe pension pleqërie në vlerën 20,842 lekë.

Menjëherë

5.1 Gjetja nga auditimi: Komuna Voskopojë me 7 subjekte me të cilat ka lidhur kontratat për dhënien me qira për 3 ha, sipërfaqe pyjore të transferuara në pronësi të Komunës me VKM, por të pa regjistruara në ZVRPP Korçë dhe deri më datën 30.07.2014 në 5 prej tyre nuk janë zbatuar kontratat e lidhura, duke krijuar **një të ardhur të munguar** në buxhetin e Komunës Voskopojë në vlerën **504,700 lekë**.

5.2 Niveli i prioritetit.

Vlera e mësipërme në shumën 504,780 lekë ka nivel të lartë prioriteti dhe është me ndikim të lartë në pasqyrat financiare të subjektit auditues.

5.3 Rekomandimi: Komuna Voskopojë të marrë masa që për 5 subjektet të cilët nuk kanë zbatuar kontratat e lidhura, në se nuk paguajnë në mënyrë vullnetare, të kërkohet në rrugë ligjore zbatimin e tyre, duke arkëtuar vlerën e qirave prej **504,700 lekë**, si më poshtë:

1. Në vlerën 13,500 lekë, dy qytetarëve, V.K. dhe K.K. qira e papaguar për vitin 2013 për sipërfaqen pyjore të dhënë me qira prej 3000 m², për Objektin “*Kampingje për argëtim*” fshati Voskopojë, Kontrata me numër 196, prot, datë 18.09.2012 kohëzgjatja për 9 vjet, nga data 18.09.2012-18.09.2021.

2. Në vlerën 140,800 lekë, dy qytetarëve P.M. dhe G.X. qira e papaguar për vitin 2013, për sipërfaqen pyjore të dhënë me qira prej 20.300 m², me objekt “*Kampin dhe mbarështim faunës së egër dhe gjahut*” fshati Voskopojë, vlera e qerases 140,800 lekë.

3. Në vlerën 50,400 lekë, subjektit G.Sh. qira e papaguar prej 2 vjetësh 2012-2013, për sipërfaqen pyjore të dhënë me qira për objektin “*Për akuakulture*”, fshati Voskopojë, kontrata nr. prot, ska, datë 20.05.2003 vlera e qerases vjetore për 25,200 lekë, për një afat 9 vjeçar.

4. Në vlerën 300,000 lekë, subjektit “A..T..” sh.a, qira e papaguar për sipërfaqen pyjore të dhënë me qira prej 500 m², me objekt “*Vendosje Antene, fshati Voskopojë*” kontrata është përsëritur më datën 23.06.2014 me afat 7 vjet, me qira mujore prej 300,000 lekë, nga data 3.04.2014 deri 23.04.2014.

5. Në vlerën 132,000 lekë, subjekti B..D, qira e papaguar për vitin 2013, për sipërfaqen pyjore të dhënë me qira prej 3300 m², për vitin 2013, me objekt “*Nxjerrje inerte*” fshati Voskopojë, ura e Kovaçit, Pasuria nr. 1144, Kontrata me nr. prot 213, data 10.10.2012 kohëzgjatja me afat 9 vjeçar nga data 10.10.2012-10.10.2021, vlera e qerases vjetore 132,000 lekë.

Deri më datën 30.11.2014

6.1 Gjetja nga auditimi: Nga verifikimi në teren për zbatimin e projektit dhe kontratës datë 13.09.2012 për objektin “*Ndërtimi i rrugës me kalldrëm*” me vlerë prej 28,573,998 lekë rezultoi se nuk janë marrë parasysh kriteret e vëna nga projektuesi dhe nuk janë zbatuar specifikimet teknike të parashikuara në pikat nr. 14, 15, 20. Duke punuar jo në përputhje me Kushtet teknike të zbatimit (mos përmbushur preventivin dhe kontratën e lidhur për zbatimin e punimeve datën 12.09.2012). Për pasojë i janë likuiduar më tepër sipërmarrësit “*B..D*” sh.p.k dhe “*H..I*”, për 8 zëra punimesh të pakryera, duke shkaktuar dëm **ekonomik buxhetit të shtetit për vlerën 2,451,254 lekë** pa tvsh.

6.2 Niveli i prioritetit: Vlera e mësipërme në shumën 2,451,254 lekë ka nivel të lartë prioriteti dhe është me ndikim të lartë në pasqyrat financiare të subjektit auditues.

6.3 Rekomandimi: Komuna Voskopojë të kërkojë në rrugë ligjore vlerën **2,451,254** lekë pa t.v.sh., për sipërmarrësin “B..D” sh.p.k dhe “H..I” për 8 zëra punimesh të pakryera në ndërtimin e objektit “Ndërtimi i rrugës me kalldrëm”. Pasi nga verifikimi në teren për zbatimin e projektit dhe kontratës datë 13.09.2012 për objektin “Ndërtimi i rrugës me kalldrëm” me vlerë prej 28,573,998 lekë, rezultoi se nuk janë marrë parasysh kriteret e vëna nga projektuesi dhe nuk janë zbatuar specifikimet teknike të parashikuara në pikat nr. 14, 15, 20 duke punuar jo në përputhje me Kushtet teknike të zbatimit.

Deri më datën 30.11.2014

7.1 Gjetja nga auditimi: Nga auditimi rezulton se për objektin “Ndërtimi i rrugës me kalldrëm” është zhvilluar tender i hapur më datën 28.08.2012 dhe fitues është shpallur Operatori “B..D & H..I” sh.p.k me NUIS K21413002P Rrethi: Tiranë, me të cilin është lidhur kontrata pa numër protokolli, datë 13.09.2012 me vlerë 28,573,998 lekë, me t.v.sh. ndërmjet Komunës Voskopojë Korçë, përfaqësuar nga kryetari i Komunës dhe operatorit ekonomik “B..D & H..I”.

Nga verifikim rezulton se punimet në këtë objekt sipas kontratës duhet të përfundonin për një afat prej 3 muaj, duke filluar më datën 13.09.2012 deri 13.12.2012. Punimet në këtë objekt janë shtyrë 2 herë për arsye të ndryshme dhe kanë përfunduar më datën 11.10.2013, ose 11 muajsh tej afatit të parashikuar në kontratë. Për efekt të kamat vonesave përlogaritjet janë kryer duke e konsideruar si afat përfundimi datën e njoftimit të përfundimit të punimeve më 11.10.2013 dërguar jo zyrtarisht Komunës, nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve.

7.2 Niveli i prioritetit.

Vlera e mësipërme në shumën 11,548,342 lekë ka nivel të lartë prioriteti dhe është me ndikim të lartë në pasqyrat financiare të subjektit auditues.

7.3 Rekomandimi: Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, Komuna Voskopojë të nxjerrë aktet administrative, të kryejë kontabilizimet dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe procedurat përmbartimore për arkëtimin e vlerës së kamat vonesave nga shoqëria kontraktuese “B..D & H..I”, në vlerën **11,548,342 lekë**.

Deri më datën 30.11.2014

8.1 Gjetjet nga auditimi: Hartimi i projekt-preventivit të punimeve për objektin “Ndërtim rruge me kalldrëm në Voskopojë” rezulton se nuk është bazuar në VKM nr. 407, datë 27.06.2012 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” me përjashtim të disa zërave, duke rritur në mënyrë artificiale llogaritjen e fondit limit dhe shkaktuar një dëm ekonomik për vlerën 754,692 lekë, në kundërshtim me:

a) VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu-II-të, Rregullat e përgjithshme të prokurimit”, pika 2, shkronja c) “Llogaritja e vlerës kontratës”
b) VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, në pikën 12 të tij, në mënyrë eksplicite shkruhet se: Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë prokurime të punimeve të ndërtimit me fonde publike, nga Buxheti i Shtetit apo nga donatorë të huaj, detyrohen të kontrollojnë çmimet për zërat e punës, të ofertave të paraqitura në tender, me

çmimet e bazuara në manualin e çmimeve të ndërtimit dhe në analizat teknike të këtyre çmimeve, të llogaritura, me programin e miratuar.

10.2 Niveli i prioritetit.

Vlera e mësipërme në shumën 754,692 lekë ka nivel të lartë prioriteti dhe është me ndikim të lartë në pasqyrat financiare të subjektit auditues.

10.3 Rekomandimi: Komuna Voskopojë të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e shumës **754,692 lekë**, ndaj 3 antarëve të Njësisë së Prokurimit, secili, me nga 251,564 lekë, respektivisht: A.Z. ekonomist i jashtëm Komuna Voskop, *David Bani*, specialist i shërbimeve dhe turizmit dhe Y.N. ish-inxhinier topograf, si rezultat i mos llogaritjes të sakte të fondit limit për më tepër në objektin; “*Ndërtim rruge me kalldrëm në Voskopojë*”.

Deri më datën 30.11.2014

B. MASA DISIPLINORE:

a-Në zbatim të nenit 72 pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*” i ndryshuar, Kreu X, pika 3, mbështetur në kreu IV, neni 11, germa “e” dhe “ç” nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “*Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, i kërkojmë Kryetarit të Komunës Voskopojë, në cilësinë e autoritetit kontraktor, që për shkeljet e konstatuara në zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike, të fillojë procedurat për marrjen e masave disiplinore “*Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna*”, për 4 punonjësit si më poshtë:

1. **J.H.** sekretar i këshillit të komunës, në cilësinë e anëtarit të KVO.
2. **L.S.** me detyrë Përgjegjës e zyrës Financës, në cilësinë e anëtarit të KVO.
3. **J.M.** me detyrë Përgjegjës i Zyrës Urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të KVO.
4. **D.B.** me detyrë përgjegjës i zyrës shërbimeve, në cilësinë e anëtarit të KVO.

Pasi:

1-Në tenderin “*Blerje karburant DI, 2011*”, rezulton se subjekti “**M.i**” sh.p.k. nuk ka në objektin e ekstraktit të regjistrimit tregtar “*importin e naftës dhe nënprodukteve të saj*” dhe në ofertat e tyre nuk kanë paraqitur raport analizimi para zhdoganimit për furniturën e tyre dhe fletë analizat për të vërtetuar cilësinë e karburantit.

2-Në tenderin “*Blerje karburant DI, 2013*”, rezulton se subjekti “**M.i**” sh.p.k. nuk ka në objektin e ekstraktit të regjistrimit tregtar “*importin e naftës dhe nënprodukteve të saj*”. Në ofertat e tij ka paraqitur raport analizimi tregun e brendshëm të datës 6.12.2012 dhe jo për furniturën e importuar.

3-Në tenderin “*Blerje karburant DI, 2012*”, rezulton se subjekti “**M.i**” sh.p.k. nuk ka në objektin e ekstraktit të regjistrimit tregtar “*importin e naftës dhe nënprodukteve të saj*”. Në ofertat e tij ka paraqitur raport analizimi tregun e brendshëm të datës 23.12.2011 dhe jo për furniturën e importuar.

4-Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Gjelbërim i territoreve publike në komunën Voskopojë, 2012*”, operatori i kualifikuar “**V.-Co & A. 2002**” sh.p.k në kontratën e bashkëpunimit datë 17 nëntor 2012 kanë përcaktuar % e punimeve që do të kryejë secili operator por nuk është i ndarë me zërat konkrete të punimeve që do të kryejë secili sipas preventivit të paraqitur, në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, kreut VII, pika 2, germa b; “*... përcaktohen përqindja e pjesëmarrjes së punës..... dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi... ”.*

Kualifikimi i 2 operatorëve “M.i” dhe “V..Co & A..2002” sh.p.k në 4 tenderat e mësipërm, është në kundërshtim me VKM nr. 1. Datë 10.01.2007, kreut V, pika 4, germa ç; “.....komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat ligjore, administrative e kualifikuese, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, apo që nuk janë me çmim anomalisht të ulët, sipas formulës së përcaktuar në rregullat e prokurimit publik...” dhe komisioni i vlerësimit të ofertave në këtë rast duhej të kishte ndërprerë procedurën dhe të kërkonte fillimin e një procedure të re sipas VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreut VII, pika 1, germa a, “Që të vazhdojë procesi i përzgjedhjes së fituesit në vijim të procedurës së hapur, kufizuar, konkursit të projektimit, kërkesës për propozim dhe shërbimeve të konsulencës duhet të pranohen të paktën 2 oferta të vlefshme. Në të kundërt, autoriteti kontraktor ndërpret procedurën dhe fillon një procedurë të re, dhe, nëse kjo dështon përsëri, zbaton procedurat e parashikuara në nenin 32 ose 33, të LPP-së, nëse ekzistojnë rrethana të tilla.”.

5-Në tenderin me objekt: “Ndërtim rruge me kalldrëm ne Voskopoje për vitin 2012”. u konstatuan shkelejt e mëposhtme:

a-Subjekti kryesues B..D ka një numër mesatar punonjësish 13.5 punonjës për periudhën janar -qershor 2012 në një kohe qe sipas përqindjes duhet të kishte një numër mesatar prej 20.3 punonjës. Ku sipas vërtetimit nr. 448 prot/1, datë 03.08.2012 lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, (Drejtoria e Shërbimeve të Tatimpaguesve), janë përshkruar numri i kontribuesve dhe pagesa për 6 mujorin e parë 2012, respektivisht: muajin: Janar- 12; Shkurt - 12-Mars-11; Prill 15; Maj-15; Qershor-16 = 81 muaj ;6= 13.5, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” pika b

b- Për kriterin Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës Shoqëria B..D si shoqëri kryesuese nuk ka kategoritë e punimeve N.P- 4/B, N.P-5 /B ,NP-12/A, NS-5/B, N.S - 9/A, N.S -19/B në kundërshtim me nenin 46 pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”.

Dhe në kundërshtim me VKM, nr. 1, dt. 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu VII “Kushte të përgjithshme për zbatim” pika 2/c, “Çdo operator ekonomik duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. “Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë grupi i marrë së bashku, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje

c-Shoqëria kryesuese B..D, nuk plotëson kushtin e certifikatave të kërkuara: Operatori ekonomik te jete i pajisur me certifikate ISO 9001-2008 dhe me certifikate ISO 14001-2004. Këto certifikata janë paraqitur vetëm nga operatori ekonomik “H..I” ndërkohe qe ISO 9001-2008 është certifikate për cilësi ne punime ndërtimi ndërsa ISO 14001-2004 për ruajtjen e mjedisit gjate punimeve të ndërtimit, pra subjekti kryesues i shoqërisë nuk është i certifikuar. Veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” pika b.

d-Shoqëria kryesuese B..D nuk ka punime te ngjashme. Kjo shoqëri ka paraqitur dokumentacion, formular vlerësimi, akt kolaudimi, leje ndërtimi, situacione dhe fatura tatimore për objektin : *Godine banimi dhe shërbimi 9-10 kate mbi toke dhe 1 kat nëntoke ne zonën plazh Durrës*. Kjo kontrate nuk vlerësohet si punim i ngjashëm pasi i parket kategorisë se licencës NP2 (godina civile dhe industriale) kategori që nuk është kërkuar në realizimin e objektit nga Autoriteti kontraktor, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” pika 1/b.

D.MASA ADMINISTRATIVE:

d.1. Për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.

Mbështetur në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr.8599, datë 01.06.2000, bazuar në Vendimin e Këshillit Ministrave nr. 42, datë 16.1.2008 “ Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së Liçencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ndryshuar me VKM nr. 92, date 19.02.2014, Kreu VII, “Sanksione”, pika 1,shkronja (a), Pika I- Konstatohen ose provohen deklarime, të rreme, i rekomandojmë Komisionit të dhënies së Liçencave, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, që për shkelje të ligjshmërisë në ndërtim të vendosë sanksionet si më poshtë:

-Heqjen e Liçencës, për një afat prej 1 (një) viti, z. A.T., mbikëqyrës i punimeve.

Për shkeljet e mëposhtme:

Për ndërtimin e objektit “Shtrimi i rrugës me kalldrëm” është zhvilluar tender i hapur më datën 28.08.2012 dhe fitues është shpallur-Operatori “B..D.& H..I” sh.p.k, me të cilin është lidhur kontrata pa numër protokolli, datë 13.09.2012 me vlerë **28,573,998 lekë**, me t.v.sh. Për ndjekjen e punimeve të këtij objekti, ndërmjet Kryetarit të Komunës dhe mbikëqyrësit të punimeve **z. A.T.** është lidhur kontrata pa numër protokolli, datë 14.09.2012, i cili do të paguhet për vlerën 450,000 lekë, (por deri më datën 20.07.2014, nuk ishte kryer asnjë likuidim).

Për periudhën nga lidhja e kontratës datë 13.09.2012 deri më datën 24.07.2014 kur kanë kaluar mbi 24 muaj ose 2 vjet, nga vlera e kontratës prej 28,573,998 lekë i janë likuiduar Operatori Fitues “B..D.& H..I” sh.p.k vlera prej 18,372,282 lekë, duke mbetur pa u likuiduar edhe vlera e punimeve prej 10,201,716 lekë ose në masën 35 %.

I. Më datën 11.10.2013 nga mbikëqyrësi i punimeve z. A.T. është hartuar Relacion Teknik Përfundimtar ku në pikën pika 7- **Konkluzione sqarohet se:**

- a. punimet janë kryer sipas projekt-preventivit.
- b. Punimet janë kryer në bazë të kushteve teknike të zbatimit.
- c. Sipërmarrësi ka plotësuar dokumentacionin teknik dhe ligjor.
- d. Nuk ka patur probleme teknike të zbatimit të projektit.

Mbikëqyrësi konkludon se punimet janë realizuar me cilësi të mirë dhe parashikon që nga ana teknike nuk do këtë problem dhe garanton funksionimin e objektit.

Procesverbalet e përfundimit të punimeve dhe Relacioni përfundimtar i Mbikëqyrësit të punimeve z. A.T. se punimet kanë përfunduar sipas projektit, **nuk qëndrojnë** pasi më datën 24.07.2014, pas gati 2 vjet nga fillimi i punimeve sipas kontratës datë 13.09.2012 dhe 10 muaj nga data 11.10.2013, ku relatohet si datë e përfundimit të punimeve, punimet nuk janë marë dorëzim nga investitori.

Nisur nga mangësitë për riparimin e defekteve nga kryetari i komunës, është hartuar Akt-Marrëveshja nr. 284, datë 25.07.2014, duke rikërkuar përsëritjen e punimeve në të dy segmentet e rrugës, si më poshtë:

- Rruga “Rilindja Voskopojare” me gjatësi rreth 230 ml dhe gjerësi rreth 6 ml ne pjesën e shtratit te rrugës **duhet te riparohet nga dëmtimet e vërejtura** gjate periudhës se provës në 100% të gjatësisë dhe gjerësisë së saj.

- Rruga "Gjergj Simon Sina" me gjatësi rreth 190 ml dhe gjerësi rreth 6 ml ne pjesën e shtratit te rrugës duhet te riparohet nga dëmtimet e vërejtura gjate periudhës së provës në 60% të gjatësisë dhe gjerësisë së saj.

II. Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren, **rezultojnë diferenca në volume pune të pakryera në vlerën 2,451,254 lekë pa T.V.SH, mangësi në dokumentacion si dhe problematikat si më poshtë:**

1. Mangësi në dokumentacion:

-Mungon plan-organizimi i punimeve të ndërtimit;

-Mungon libri i kantierit;

-Mungojnë provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve të përdorura. Për materialet e përdorura, shtresat e rrugëve dhe për punimet elektrike nuk rezultojnë të jenë bërë provat me ngarkesë dhe ato pa ngarkesë për punimet elektrike;

-Mungon dokumentacioni për masat e sigurimit teknik dhe pajisjen me mjete mbrojtëse përkatëse si dhe libri i instruktimit teknik në punë;

2. Mangësitë në zbatimin e punimeve. Nga verifikimi në terren rezultoi se:

-Trupi i rrugës nuk është realizuar në mënyrë uniforme. Ai rezultoi me deformacione të dukshme dhe nga sondazhet e kryera u vërejt se nuk është realizuar shtresa 15 cm me çakëll natyror. Gjithashtu shtresa e sipërme, shtresa direkt nën kalldrëm kishte prani balte dhe nuk rezultonte të ishte çakëll makinerie siç përcaktohet në specifikimet teknike të ndërtimit (pika nr. 5). Mangësitë në këto dy shtresa kanë sjellë edhe problemet e deformimit të rrugës;

-Shtresa e betonit nën bordurën aksiale dhe të ndërmjetme rezultoi e dobët. Për betonin e përdorur nuk janë mbajtur kubikë dhe nuk janë realizuar prova për të vërtetuar markën M-150 siç kërkohet në specifikimet teknike të ndërtimit (pika nr. 8 dhe 9);

-Shtresa e kalldrëmit me gurë të latuar $t=15$ cm në rrugën kryesore dhe 10 cm në trotuar rezultojnë të jetë jashtë çdo parashikimi nga ato të specifikimeve teknike. Ndër problemet kryesore janë ato të vendosjes së gurëve në mënyrë të çrregullt, të palatuar në faqet e dukshme, jo në formë drejtkëndore me përmasa afërsisht 20 x 25 cm.

Në asnjë rast nuk vërehen fugat të jenë ortogonale në të dy drejtimet e rrugës, gjatësor dhe tërthor. Montimi i gurëve të kalldrëmit nuk është realizuar në çakëll makinerie siç parashikojnë specifikimet teknike por në një shtresë me përmbajtje granili dhe balte e cila ka sjellë edhe problemet e deformimit të rrugës dhe krijimit të disniveleve.

Fugat midis gurëve, përveçse nuk janë realizuar ortogonale në të dy drejtimet për të qenë në përputhje dhe në përshtatje me ambientin e Komunës, nuk janë realizuar as me pluhur granili-çimento dhe më tej me lagje për të krijuar ngurtësimin nevojshëm në fugë. Në asnjë rast nuk është marrë në konsideratë gjerësia 2-2.5 cm e fugave të thelluara.

Nga sa më sipër tregon se nuk janë marrë parasysh kriteret e vëna nga projektuesi dhe nuk janë zbatuar specifikimet teknike të parashikuara në pikat nr. 14, 15, 20 dhe është punuar jo në përputhje me K.T.Z. (duke mos përmbushur preventivin dhe kontratën e lidhur për zbatimin e punimeve më datën 12.09.2012). Sa më sipër, i janë likuiduar më tepër **sipërmarrësit "B..D" sh.p.k dhe "H..I" për 8 zëra punimesh të pakryera, duke shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të shtetit për vlerën 2,451,254 lekë pa tvsh.**

Relacioni i Mbikëqyrësit z. A.T. se punimet kanë përfunduar sipas projektit, më datën 11.10.2013, **nuk qëndrojnë pasi më datën 30.07.2014**, pas gati 2 vjet nga fillimi i punimeve sipas kontratës datë 13.09.2012 dhe 10 muaj nga data 11.10.2013, ku relatohet si datë e përfundimit të punimeve, **pavarësisht se kanë mbetur pa u likuiduar edhe 35 % të vleftës kontratës, punimet në këtë objekt ende nuk janë marrë dorëzim nga investitori.**

III. Nga auditimi i dosjes të zhvillimit të tenderit zhvilluar më datën 28.08.2012, me objekt: “Ndërtim rruge me kalldrëm ne Voskopojë” për vitin 2012, në specifikimet teknike, datë 15.08.2012, është modifikuar detyra e projektimit, nga materiali nga GUR I KUQËREMTË, në GUR PLLAKOR RANOR KUARCOR, ndërkohë nuk ekziston në dosjen e prokurimit (Inventari i paraqitur) miratimi nga Projektuesi i Objektivit dhe mostrat, dimensionet apo fotografitë e gurit. Veprim në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit“, nenin 9, ku përcaktohet se, **zbatuesi i punimeve duhet të njoftojë në seksionin e urbanistikës dhe inspektoratin ndërtimor e urbanistik, në nivel bashkie/ komune/qarku dhe INUK-ja, kur kërkohet nga kjo e fundit, për zonat me rëndësi kombëtare përpara fillimit të punimeve.** shkronja c) **Dokumentacioni përkatës i të gjitha ndryshimeve të mundshme, që mund t'i jenë bërë projektit gjatë ndërtimit të objektivit.**

D.2. Për Agjencinë e Prokurimit Publik,

Bazuar në nenin 13, pika 3/ç, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe udhëzimin e KM, nr. 01, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit publik” i ndryshuar. KREU i VIII, pika 2/a “Mbikëqyrja e Kontratës”, **i rekomandojmë** Agjencisë së Prokurimit Publik, **përfundimin e Kontraktorit** “Operatori “B..D.& H..C” sh.p.k., nga pjesëmarrja në prokurimet publike për një periudhë 1 vjeçare, pasi Operatori ekonomik “B..D.& H..C” sh.p.k nuk është përmbushur detyrimi për përfundimin në afat të objektivit “Ndërtim i rrugës me kalldrëm”, sipas kontratës datë 13.09.2012.

F. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR OË NUK KANË ADRESIM INSTITUCIONAL

Për 6 ish-punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “**Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna**” përkatësisht.

- 1.L.F. anëtar i KVO, ish-Përgjegjës i Zyrës së Taksave, larguar më datën 30.04.2013.
- 2.N.Th. ish- përgjegjëse e zyrës urbanistikës, ka qene në pension pleqërie.
- 3.E.Z. anëtar i KVO, jurist i jashtëm, pa kontratë.
- 4.Y.N. ish-inspektor i bujqësisë, larguar më datën 31.01.2014
5. A.Z. Punonjës i jashtëm komuna Voskop anëtar i KVO.
- 6-V.K. ish-punonjës policie, larguar më datën 30.04.2014.

Për punonjësit e mësipërm të njoftohet Departamenti i Administratës Publike për masat disiplinore me qëllim kryerjen e regjistrimeve të nevojshme në Regjistrin Qendror të Personelit.

D. KALLËZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281, me shkresën nr. 451/8, datë 08.10.2014 kemi bërë kallëzim penal duke dërguar për veprime të mëtejshme procedurale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë:

z. A.T. me detyrë mbikëqyrës i punimeve.

Nga Komuna Voskopjë, me shkresë nr. 432, prot, datë 31.10.2014, protokolluar në KLSH me nr.451/13 datë 06.11.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Niko Nako, Bexhet Zeqiri, Luan Kuka dhe Jonild Hoxhaj, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT